



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË SHITATË TË RREGULLT TË KUVENDIT KOMUNAL TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më dt: 28.07.2016 (E enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu, këshilltaret e Kuvendit, Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Arbresha Ibrahim, Vjollca Kadolli - Halili, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Bislim Bislimaj, Sejdi Emini, Baki Nebiu, Daut Xhemajli, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Mirlinda Sadiku, Majlinda Ostrogllava, Selvije Rexhepi, Besjana Rexhepi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, zyrtari i lartë për demarkacion në regjionin e Gjilanit, mjetet e shkruara dhe elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Përshëndetje për Nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju Anëtarë të KK-së, Zyrtarin e lartë për demokratizim ne misionin e OSBE-se qendra regjionale ne Gjilan z.James Jallan, i cili sot është prezent ne këtë seancë, Drejtorë e drejtorive si dhe Ju të pranishëm, dhe mirë se keni ardhur ne mbledhjen e VII të rregullt të KK-së! Para se te kalojmë në rendin e ditës, më lejoni te ju falënderojë për prezencën e juaj gjate vizitës se ambasadorit amerikan, te cilin e patëm me datën 19.07.2016, ne komunën tonë, e me te vërtet vizita e tije neve si komune na ka nderu jashtëzakonisht shumë, dhe gjithashtu dëshiroj të ju informoj, se Zyra Ligjore e Ministrisë se Administrimit të Pushtetit Lokale, na ka konfirmu ligjshmërinë e akteve, te cilët i kemi nxjerr ne si Kuvend Komunale. Natyrisht ju falënderoj te gjithë juve për kontributin e dhënë. Gjithashtu për juve si asamblist edhe për qytetaret e Komunës se Vitisë duhet te ju njoftoj, se duke u bazuar ne raportin e mozaikut të Kosovës për vitin 2015, që paraqet perceptimin dhe opinionet e te anketuarve nga 38 komuna të Kosovës, lidhur me

kënaqshmërinë e tyre ne fushat e ndryshme, del se ne komunat e lindjes qytetaret e komunës se Vitisë kane një kënaqshmëri jashtëzakonisht te madhe ne punën e Kryetarit te Komunës se Vitisë dhe me punën e Kuvendit te Vitisë, ne përgjithësi diku në 75.5% është kënaqshmeria e qytetareve te Komunës se Vitisë në punën e kryetarit te Komunës së Vitisë dhe diku në 76.9% është kënaqshmeria e qytetarëve te Komunës se Vitisë ne punën e Kuvendit Komunal të Vitisë, çka qe e bënë qe te renditmi ne rendin e parë ne komunat e lindjes. Nuk dëshiroj qe ti përmendi komunat te cilat janë mbrapa neve, por është një dallim jashtëzakonisht i madhe ne mese neve dhe komunave te cilat i kemi ne si komuna fqinje, gjithashtu edhe ne bazë te raportit te monitorimit te Komunës se Vitisë del se Komuna e Vitisë ka pas një performancë te jashtëzakonisht te madhe, po thuaj qe janë respektuar te gjitha procedurat ne hartimin e akteve dhe i kemi marr edhe raportin e monitorimit te komunave, që është një raport jashtëzakonisht i kënaqshëm me disa rekomandime jashtëzakonisht te vogla, të cilat shpresoj qe në të ardhëm do të evidentohen. Gjithashtu edhe një informatë dëshiroj ta ndaj me ju, ju e dini që para një periudhe 5-6 mujore, ka te bëjë me mu si kryesues i Kuvendit Komunal, Gjykata Themelore kishte ngrit një aktakuzë rrethe mëditjeve te marra nga ana e këshilltarëve komunale dhe ka qenë një procedurë gjyqësore. Aktakuza e tillë u hodh poshtë si e pa bazë. Unë ju falënderoj te gjithë juve për mbështetje, natyrisht edhe për kontributin qe e keni dhënë ne këtë aspekt dhe komplimente për drejtuesen, e cila ne mënyrë korrekte ka gjyku një rast te tillë. Dhe krejt ne fund, me që jemi tash para miratimit te buxhetit, Komuna e Vitisë me kohe ka bërë përgatitjen dhe ka përgatitur një agjend te organizimit te takimeve nëpër lokalitete te ndryshme dhe me organizata te ndryshme. Drejtoria përkatëse ka bërë një orar, i kemi marr me veti, ku sekretaria do ta shpërndan një gjë të tillë, natyrisht shpresoj qe edhe ju si këshilltar komunal, kryesisht nga vendet te cilat vini, të jeni pjesë aktive e këtyre dëgjimeve buxhetore. Meqë jemi ne muajin korrik, dhe fillimi i gushtit kemi Ditën e Diasporës, Komuna e Vitisë gjithashtu e ka një agjend te organizimit dhe pritjes se bashkatdhetarëve nga vendet e ndryshme te Evropës. Agjendën do tua shpërndajnë juve dhe dëshirojmë qe te jeni pjesë aktive e këtyre organizimeve, dhe para se te kalojmë ne miratimin e rendit te ditës, si zakonisht ne kemi pyetje dhe propozime, fjala është për ju, nëse ka dikush ndonjë pyetje apo propozime.

znj.Besiana Rexhepi: Faleminderit! I nderuari Kryesues, te nderuar Koleg Drejtor te drejtorive! Kame një pyetje, çfarë kriteriumi po bazoni rreth shtrimit te asfalteve ne lokalitete e deri tanishme, pasi që ka qytetar qe ankohen në mos përfshirjen në këtë proces, apo thjesht është një fushat nga ana juaj.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje për te gjithë të pranishmit, Kryesues, Nënkyetar, ne veçanti Diasporën, qe kurrë nuk u kursyen për këtë vend, e sidomos faleminderit për diasporën e Lybishtes, qe ndërtuan pesë shtëpi, po ashtu për një grup vajzave të cilat bënë renovimin e shkollës se Debolldehut, me të vërtet e meritojnë një falënderim. I kam dy pyetje për Drejtorinë Komunale te Arsimit. Drejtor, ju e dini që në shkollën Skifteraj, kulmi është ne gjendje te mjerueshme, aty vetë drejtori i shkollës është mundu me intervenu pak, mirëpo ajo paraqet rrezik edhe për jetën e fëmijëve ne atë shkollë, po ashtu edhe shkolla ka nevojë për një renovim total. Mirëpo tu e ditë qe buxhetit i kanë cunuar diku rrethe 70 mije euro,

brenda mundësive, së paku që të intervenoni ne kulme. Pyetja tjetër: Pse u anuloi konkursi për drejtor të shkollave fillore si dhe për çerdhe.

z.Bekim Azizi: Faleminderit Kryesues! Përshëndetje për Nënkryetarin, Drejtorët, Anëtarët e Kuvendit, përfaqësues të tjerë që janë prezent këtu. E dimë që raporti i auditorit për vitin 2015 tash është bërë publik. Kisha kërkuar që seancën e ardhshme me qenë një pikë e rendit ditës që e bënë informimin për këtë raport, çfarë raporti kemi. Tu e pas parasysh që ka ndodhur një fatkeqësi në pjesën e Ramjanit, atje në Bagdat, që është mbytur një fëmijë, zona është e Vitisë, mendoj që duhet me na informuar organet e juaja, se cili ka qenë problemi i asaj gropë, ai akomolim i ujit, pse e kanë bërë atë akomolim të ujit, se ajo nuk kishte qenë gropë e KFOR-it, por kishte qenë gropë private e bërë për ujitje, pse nuk është ruajtur, ajo a ka pas informata pushteti për atë gropë që është, d.m.th se një gropë 9 metra me ujë mu kanë mbushur dhe mu myt fëmija, d.m.th se një informatë duhet me pas na të saktë, pse ka ndodhur kjo. Një pyetje tjetër, qeky trotuari të "Rruga e UCK-se", që është duke u bërë, pse nuk ndërrohet gypi i asbestit, pse behën dy here punët. Na e dimë që ne dy anët e lumit është gypi i asbestit, pa ndërruar pjesë të tjera të qytetit, është i ndërruar gypi i ujit, pse nuk bahet ndërrimi i gypit para se mu ba trotuari. Unë mendoj që duhet të ndermirren masa që të ndërrohet gypi, pastaj të rregullohet trotuari. Ju faleminderit!

z.Sejdi Emini: Përshëndetje për të gjithë! Unë sot prapë do ta ngriti një çështje, e cila ka të bëjë dhe është shumë e rëndësishme për banorët e komunës tone, çështja e autostradës. E kemi ngrit edhe me herët, nënkryetari na ka thanë që kemi me keshyr çka është e mundshme kemi me bërë, mirëpo unë sot jam i interesuar me ditë çka keni bërë për atë punë edhe a ka gjasa me pas kyqje edhe ne. Pyetja tjetër është nga disa banorë të Trestenikut. Rruga e Trestenikut, rruga kryesore, është pothuajse e pa kalueshme. Ata banorë atje ishin bukur në vështirësi. Pos kësaj rruge, edhe rruga kryesore e Gushices, hiq nuk është me e mirë, sigurisht e keni parë edhe ju, ju ka ra me ardhur ka një herë edhe ajo rrugë pothuajse u bë e pakaluar, ata banorë që kanë ato makina, janë ka i dëmtojnë për çdo ditë edhe jo mu shtruar vetëm 500 metra, qyshe po i shtrojnë gjysmë një herë e gjysmën mas dy vite, po ajo rrugë do mu shtruar krejt, fund e krye, sa është rruga aq duhet edhe të shtrohet, për 500 metra mos e nisni hiq, po ju them haptas, shtrone rrugën qyshe duhet me shtruar edhe me cilësi. Kame edhe disa kërkesa të disa banorëve të fshatit Skifteraj, ishte një rrugë atje rrugë e arave, kishte bukur shumë bashkë të mjellura atje, perime kishte shuë, e shalqin, pjepna, dhe ata e kishin problem edhe me i nxjerr ato perime prej aty, me i qit në treg, prandaj shkoni vizitoni edhe me ju ndimur atyre banorëve, se ata atë punë që e kanë bërë ashtu kështu nuk e kanë gjendjen për lakmi, është mirë me ju ndimur. Nënkryetar, e kam përmendur edhe me herët, po e përmendi edhe sot, i kemi dy fshatra që e kanë një projekt të filluar para 7-8 vite, projektin e ujësjellësit, unë nuk e di qyshe po mujna me fillu punë të reja pa i kryer punët që janë para 8 vite ose 6-7 vite, është marrë përgjegjësi dhe janë gjysma pa ujësjellës, i kemi fshatin Germovë dhe Gushice, që 8 vite është fillu projekti, është ardhur deri në hymje të fshatit dhe nuk vazhdojnë ma ato punime, është normal që kushtojnë, ama me ni rreshte me i kry qato që janë gjysmë, tani me fillu tjerat, se sa me kanë qashtu.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi qe nuk ka te tjerë për diskutim, ja japim fjalën nënkryetarit, pasi qe u parashtruan disa pyetje.

Nënkryetari z.Hasan Alia: Fillimisht me lejoj ta përshëndes kryesuesin e Kuvendit, juve Këshilltar te nderuar, Drejtoret e drejtorive, përshëndes me një përshëndetje te veçantë edhe Jems Jallanin, zyrtar i lartë për demokratizim pran zyrës regjionale ne Gjilan, diasporën. Unë vetëm po ja bashkëngjisë asaj, se Mirlinda, se vargu i njerëzve nga diaspora, te cilët po ndihmojnë është shume i madhe, prandaj unë po i përshëndes që të gjithë e nuk po e veçoj asnjë, ngase qe te gjithë ata qe janë ne boten e jashtme po ndihmojnë e kane ndimu dhe po e ndihmojnë vendin e tyre, varësisht se ku jetojnë dhe veprojnë. Sa për informim, e kemi një grup qe nesra po e nis një shpi sociale, një grup nga Austria, prandaj nuk po i dalloj me emër. Pyetja e cila ishte ne adresë te ekzekutivit, është e këshilltares, e cila tha me çfar kriteriumi po i asfaltoni rrugët nëpër fshatra apo rrugët rurale. Unë konsideroj, se nëse e keni përcjell procesin e projekteve, jemi një prej komunave qe me se shumti kemi pas dëgjime buxhetore, i kemi pas 20, jemi një prej atyre komunave, të cilët bashkëpunimin me këshillat e fshatrave e kemi ne kulminacionin më të madh të mundshme dhe te gjitha rrugët te cilat po zbatohen ka qenë ideja e ati lokaliteti dhe ne kuadër te propozimeve te tyre ekzekutivi ka zgjedhe dy, tri a po e ka shiqu kapacitetin buxhetor se sa e ka. Me përgjegjësi të plotë po ju themë, nuk ka as një rrugë e cila u shtru, qe nuk ka qenë e propozume nga këshillat e fshatrave apo këshillit te qytetit. Pyetja tjetër ishte rrethe konkursit te drejtorëve te shkollave. Kanë qenë një komision, është një udhëzim administrativ, të cilin e ka aplikuar drejtori i drejtorisë, por megjithatë në takimin e fundit, të cilin e ka pas kryetari i komunës me dy sekretarët permanent, sekretarin e Ministrisë së Arsimit dhe sekretarin e Ministrisë se Administrimit Lokal, janë dakord qe procedurat duhet me i udhëheqë Zyra e Personelit, ndërsa procedura tjetër masandej vazhdojnë i udhëheq DKA-ja. Prandaj, pikërisht për këtë mos me ardh deri te një anulim i konkursit apo ripërtëritjes së konkursit. Ne jemi dakord dhe për momentin u rikthy dhe janë ne procedurë, vetëm kanë shku edhe ne Ministri të Financave, që duhet me marr lejen për me e shiqu a ka mjete dhe Ministrinë e Administrimit te Pushtetit Lokale dhe do te behet ajo se nuk ka kurnifar te keqe. Gjendjen në shkollë siç e paraqiti Mirlinda, unë shkoj si shpesh, e nuk është qashtu, nuk rrezikohet as një nxënës aty, se shkolla ne Skifteraj i ka diku qe 7-8 vjet qe është ndërtuar, një shkollë shumë e re, mun me piku, po nuk është në gjendje të mjerueshme, e qe rrezikohen nxënësit. Edhe unë pajtohem qe mundet me pas nevojë për renovime, por mos t'i zmadhojmë çështjet çka nuk janë. Raportin qe e kërkon Bekimi, mundet te vjen ne shqyrtim edhe besoj qe shume shpejt do te vjen ne shqyrtim. Në çështjen e Ramjanit, me të vërtet është për keqardhje, ka ndodhë aty një tragjedi, është ne rajonin e Komunës se Vitisë, po e them me sinqeritetin me te madh, institucionet e Komunës se Vitisë e kane bërë maksimumin qe munden, megjithatë po te informoj, se i kame pyet drejtorat e drejtorive, nuk ka pasur leje ai i cili e ka bërë atë. Me çështjen e tille është duke u merr prokuroria, i ka marr edhe fletat poseduese edhe kopjen e planit për pronën. Se e kujt është kjo çështje, krejt e dikujt tjetër, ne vlen me i falënderuar njësinë e zjarrfikësve edhe QKMF- ne Viti, e cila ka qene prezentë vazhdimisht, kame qenë edhe unë si nënkryetar i komunës me kryesuesin dhe drejtorat. Ka qenë me një pozitë ndoshta u kane shume edhe problematike edhe inspektoret

ta shofin, se automjeti nuk shkon aty ku ka qenë, ka mujt mos me pas informacion. Kam bindjen qe nuk kanë pas, megjithatë është për keqardhje, se kem humbe një qytetar te Kosovës, një qytetar te Komunës se Ferizajt dhe një fëmijë në kohën e rritjes, që ne kem qenë edhe për ngushëllime. Trotuari është një projekt ne mes te Komunës dhe DEMOS-it, që është fitu një grand qeveritar, që ka participuar edhe komuna bukur shumë. Do te ishte mirë te ishe ndërruar gypi i asbesit, por ti e din Bekim, qe ne rast qe nuk e ki paraparë me buxhet dhe nuk e ki, nuk mund me e kry ato, pavarësisht që unë pajtohem qe do te ishte mirë, por ne rast qe nuk e ki paraparë me buxhet nuk mundet me e bë. Edhe unë pajtohem qe te ishin kane mjetet me mirë kishte me qen te ndërrohet gypi, pastaj trotuari. Kycja ne autostradë ishte një pyetje, përpjekjet janë maksimale te kryetarit, ju e dini qe projektin nuk e ka bërë Komuna e Vitisë, e kanë bërë qendra, ata e kanë pa ne atë formë. E di, kryetari ka pas shume takime edhe me ministrin, por jem tu bë përpjekje maksimale që të sigurohet një hyrje, por megjithatë nuk e kemi ende atë garancionin se do te bëhet, megjithatë përpjekjet janë te vazhdueshme, janë kanë dy tri takime dhe shikojmë mundësin se a ka a po jo mundësi qe te behet, duhet ta dimë qe kycja kushton, krejt kjo kushton ne implikime buxhetore, por me gjithat po punohet ne këtë drejtim. Çështje e rrugës se Trestenikut, Gushices. Unë e konsideroj qe po te kishmi pare, jo këto, po do të kishmi shtru hala më shumë. Do të jem parimor, me më pyet mu rri me shume ne zyre unë edhe i priti palët, sa kërkesat i kam, me siguri nuk do te mund te me del edhe buxheti për 10 vite, qe është i parapamë për Komunën e Vitisë, por megjithatë ajo qe mu me jep shume vullnet për punë, konsideroj qe atë shpërndarje po e bëjmë shume në mënyrë te mirë, mënyrë te drejtë po i shkojmë, p.sh.: rrugët te cilët janë me shume te dëmtuar. Jem tu ba përpjekje maksimale qe e Trestenikut, qe te hin sivjete ne projektin qe është Komollavë-Trestenik qe e kemi bë, na ja kemi qu paramasen edhe llogarinë për ketë rrugën kryesore qe te lidhet deri ne Sllatinë, dhe unë konsideroj e shume shpresoj qe ka me kalu. E edhe e Gushices ka nevojë, por ndoshta jo për këtë moment, për shkak se ka nevoja ndoshta me proritare se kjo dhe konsideroj qe për momentin është e kalueshme. Çështjen e rrugës “razverka”, unë po ti përmendi shume rruge qe kane nevojë për shtruarje. Është një realitet, qe Skifteraj merret shumë me punimin e tokës dhe ka nevojë, rrugët fushore i kemi ne gjendje qyshe i kemi, po bëjmë përpjekje për çdo vjet tu i përmirësuar nga pakë, tu hape edhe kanale, te cilët po i vërshojnë tokat tona dhe ne nuk po mujmë qe te përqendromi vetëm me një lami, po duhet ne te gjitha lamitë nga pake, dhe prandaj nuk është bashë gjendja ashtu qyshe e ki paraqit ti, ndoshta je kane një herë, unë shkoje ne atë rrugë edhe jam kane shume here, ka qenë një prej rrugëve me te mira fushore, nuk është qashtu qysh po thua ti, rruga deri aty ky është rregullu është një ndër rrugët me te mira, shume qarkullueshme. Çështja e Germoves dhe Gushices, këtë nuk kemi mujt me bë, për këtë ju e dini, kemi kërkuar edhe ndihmën e juaj. Është një bllokim, jem ne procedurë e sipër, se shpejti zotimet janë se kjo po varet nga Komunë-CDI, CDI e cila është e implementuese, e dini ja kemi bërë at pagesën te cilën ju si këshilltares te Kuvendit Komunal naj keni lejua atë mundësi qe te ja paguaj borxhin, e ku ne ja kemi pagu edhe po e shtyjmë përpara procesin për këto lokalitete, por edhe për lokalitetet për Verban e për Smir, qe del tenderi dhe fillohen punët rrethe ujësjellësit, prandaj ne këtë drejtim ne nuk jemi vonu, na ka vonu borxhi, dhe prandaj unë po shpresoj qe do te vinë ditë

më të mira dhe do të fillohet edhe në këto vende. Ju faleminderit për të gjitha pyetjet që i parashtruar!

Drejtori z.Qahil Sinani: Përshëndetje për të gjithë, për kulmin e shkollës në Skifteraj, neve kemi menduar, që këtë kulm sivjet ta shtim në ventilizim, por i kemi menduar që përmes fondacionit Kosove-Luxemburg mos po e shfrytëzojmë këtë rast, prandaj aty ka kaluar në Smirë suvatimi i brendshëm i jashtëm dhe kulmi, ndërsa edhe në Budrike është punë fusha e sportit dhe dyert brenda shkollës dhe gëlqerosja e shkollës, përmes këtij fondacioni, po ashtu edhe në Radivojce, ndërsa në Skifteraj është urgjente që duhet të ndërrohet kulmi ndriçues, jo i terë kulmi, po është kulmi ndriçues, besoj që shpejt do të intervenojmë. Sa i përket konkursit, u përgjigj nënkryetari, kjo ka të bëjë se duhet të merret pëlqimi i Ministrisë së Administratës Publike, prandaj kalon te DKA-ja e arsimit. Edhe një njoftim për shkollën e Debuldehut, çka është me rëndësi, se tri vajza, një e Begunces, një e Preshevës dhe një e Suharekës kanë formuar shoqatën Sociale në Zhenevë, kanë mbledhur një fond të mirë dhe janë ardhur për me e rregulluar një shkollë në Komunë të Vitisë. Kryetari dhe ne bashkë kemi propozuar Debuldehun, prandaj punët janë duke u bërë, aty është nxemja qendrore, suvatimi i brendshëm e i jashtëm, oborri i shkollës dhe një këndë i lojërave për fëmijë. Vlen që të përshëndes dhe t'i falënderoj në emër të DKA-se, Arsimit ato tri vajza që tregun një nostalgji të fortë për atdheun e vetë.

Kryesuesi z.Naim Pira: I falënderoj të gjithë parafolësit dhe deklaroj që në seancën e VII të rregullt të Kuvendit Komunal kemi paraparë këtë:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Kuvendit Komunal të Vitisë.**
- 2. Pasqyrat Financiare Janar-Qershor 2016**
- 3. Propozim vendim i dokumentit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Vitisë**
- 4. Plani i veprimit për transparencë në Komunën e Vitisë**
- 5. Informatë nga Drejtoria e Arsimit**
- 6. Informatë rreth procesit të korrjes-shirjeve**

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutem?, pasi që nuk ka hedhet në votim për miratim i rendit të ditës: Kush është për miratim? Konstatohet që me votat e të gjithëve u miratua ky rend dite.

Pika e parë

Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Kuvendit Komunal të Vitisë

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rreth procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? Pasi që nuk ka, hudhet në votim: Kush është që të miratohet procesverbali i mbledhja e gjashtë e Kuvendit Komunal Vitisë? Nga të gjithë asamblistët prezent pika e parë u miratuar.

Pika e dytë

Pasqyrat Financiare Janar-Qershor 2016

Kryesuesi z Naim Pira: Fjalën ja kaloj drejtorit për Financa, që të na njofton me detalisht për pasqyrat financiare janar-qershor 2016.

Drejtori z. Ibrahim Rama: Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju te nderuar Këshilltar te Kuvendit Komunal e ju te pranishëm! Si zakonisht, pasqyrat financiare tashme u bë një praktikë që e një ligji dhe në çdo tre muaj duhet me i përgatit pasqyrat financiare dhe ti prezantojmë para organeve, që janë përgjegjëse për ekzekutimin e buxhetit komunal, e ku në me kohë i kemi përgatit e ku edhe kësaj radhe e kemi përgatit materialin, e kemi sjell me kohë, besoj që e keni analizua me kohë dhe këto pasqyra financiare, është fjala për periudhën Janar-Qershor 2016, i kemi analizuar edhe në Komitetin për Politik dhe Financa, kemi marr disa sugjerime, disa vërejtje, disa pyetje që janë adresuar në kuptimin e pasqyrave financiar, këto përgatiten duke u bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Që mos të ju marri kohë me shumë, pasi që materialin e keni pranuar me kohë ju le hapësin në dispozicion për pyetje sugjerime, kërkesa, apo najë plotësime, jam i gatshëm.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethë kësaj pike.

znj.Vjollca Kadolli-Halili: Përshëndetje për nënkryetarin, kryesuesin, ju koleg dhe të gjithë të pranishmit. Kemi pasqyrat gjashtëmujore, është një dokument, i cili është punuar mirë, pasqyrat paraqesin punën reale qyshe kryhet ky gjashtëmujorë dhe është për t'u vlerësuar puna e drejtorisë që ka përgatitur dokumentin me kohë. Në këto pasqyra, gjatë analizimit flasim një gjendje inkurajuese, duke filluar nga të hyrat të cilat janë të rritura për 9 %, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjithashtu edhe investimet kapitale janë me të larta se vitin e kaluar, por edhe punët në terren të cilat i shohim përditë në shumë lokalitete të Komunës së Vitisë flasin me mirë, për një vit shpresëdhënës, për investimet dhe realizimi i planit gjashtëmujorë, pothuaj se në të gjitha drejtoritë veç e veç, mbi 90% flete për një planifikim të mirë të kësaj qeverie dhe shpenzim të parasë publike në përgjithësi dhe profesionalizëm. Ju faleminderit!

znj. Mirlinda Sadiku: I kame disa pyetje për disa kode, për disa i kame komentet e mija, p.sh.: mirëmbajtja e shkollave, vetëm 373 euro, shumë pake për mirëmbajtje të shkollave, kur e dimë se sa ka nevojë edhe sa ka hapësirë për me intervenu nëpër shkolla. Më brengose rritja e vogël e tatimi në të hyra në pronë, për kundër vendimit të qeverisë për faljen e borxheve prapë kemi një stagnim, d.m.th kemi diku vetëm 10 mijë euro të hyra, të cilat i ka arkëtuar komuna sipas UNDP-së, d.m.th, programit zhvillimor, aty parashihen që komunat ndal ngadalë të fillojnë t'i kenë buxhetet e veta edhe mos të jenë të varura shumë nga niveli qendrorë. Sipas këtyre, arketim sipas trendit mbledhjeve se taksave të mëdha është ky vizion për tu arritur, komenti imë lidhje me kodin 14/230, shpenzimet e informimit publike me Komitetin për Politik dhe Financa, naj ka afër disa shifra, mirëpo për mendimin tim, 3 mijë e 852 euro janë shumë për informim publik, pamarre parasyshe që keni dëshirë me rrite transparencën, por këtu ka të bëjë diçka, është Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, por megjithatë për nivelin buxhetor të Komunës së Vitisë edhe ashtu të varfura është shumë. Pyetje kame për kodin 13/503, janë ble kompjuter në vlerë prej 10 mijë e 998 euro, më intereson drejtor ta di, se cili institucion është përfitues i këtyre kompjuterëve, po ashtu është komenti i imi, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, 7 mijë e 362 euro, një shumë mjaft e madhe për me i riparuar dhe me i mirëmbajturë veturat është shumë. Në e dimë që i keni blerë golfat, por këto janë riparime të automjetet të zjarrfikësve, ju konsideronë, nëse është me mirë që çdo vjet të shfrytëzoni gjithë këto të holla, për tri vite të bleni një të ri, unë e kame parë nga raporti që naj kanë sjell Drejtoria e Shërbimeve Publike, që aty ka veturë e cila është e prodhuar në vitin 1976, d.m.th sa mundet me intervenu ajo me ja shpëtuar jetën dikujna e me ja shpëtuar pasurinë e paluajshme dikujt. Te kodi i Drejtorisë Komunale të Arsimit, pajisje të tjera, shuma është 5 mijë e 67 euro, me intereson ta di çka janë këto pajisje të tjera. Po ashtu prapë kemi furnizime për zyrën e Drejtorisë Komunale të Arsimit, është shuma 7 mijë e 310 euro, ku janë kry këto furnizime,

ndërsa komenti i imi është, se sa i parkete investimeve kapitale te arsimit, e kemi investime kapitale vetëm 12 mijë e 343 euro, me gjithë këto probleme nëpër shkollë, me gjithë këto nevoja me intervenu, mu ma merr mendja që kjo shumë është shumë e vogël, e me të vërtetë shkolla e fshatit Skifteraj, po mendoj ai kulmi, pjesa e brendshme, me të vërtetë është në gjendje shumë të keqe. Nuk du me ekzagjeruar as me tepruar me komente, por me të vërtetë aty ka intervenu drejtori i shkollës, për mos me pike uji brenda, dhe ajo është krejt mas drunore. Nëse ajo shkollë është ndertu që disa vite, e nëse ajo thithë ujë, ajo është strukturë ka rrezikshmëri me ra poshtë, po ju tregoj se 300 thase glaca të pëllumbave janë nxjerr prej aty. Është e patolerueshme e jo higjienike edhe është e rrezikshme, duhet me intervenu. 12 mijë euro për shkollë bashkë kurgja hiq nuk janë. Sa i parket, p.sh.: të planifikimet, e pashe aty të shkollat e mesme, të shkollat ku unë punoj, e kame potencu edhe në Komitete, që dy vite na nuk e kemi hap mësimin joformal, d.m.th aty po planifikohet mu mbledh diku rreth 12/13 mijë euro, mirëpo na që dy vite nuk kemi pasur mësim joformal. Po ashtu të shfrytëzimi i parkingut publik, janë kanë të planifikuara 3 mijë e 810 euro, janë arketu vetëm 875 euro, kjo është shumë pak.

z.Samet Idrizi: I nderuari Kryesues, Nënkyetar, Koleg Asamblistë, Drejtore e të pranishmit në këtë seancë, ju përshëndesë. Unë kame bërë një analizë edhe të planifikimi mu ka dokë mua dështim me i madhe është të planifikimi, që kemi shumë zëra këtu, dalim edhe me minus e d.m.th planifikimi u huq krejt, kemi ndryshime krahasuar me periudhën 6-mujore të vitit të kaluar. Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit është një rritje në vitin 2016, besoj që drejtori ose nënkryetari na japin sqarime pse ka rritje. Të shpenzimet e rrymës, nuk po di a behet fjalë për shpenzim apo ekzekutim të buxhetit, kemi një rënie, zvogëlim të shpenzimeve. Të uji gjithashtu kemi rritje, tash në realitet krahasuar me vitin paraprak, edhe të shpenzimet e mbeturinave kemi rritje nga 6301 në 4893, kurse të uji kemi rritje, po këtu nuk kemi ndoshta të bëjmë me kursim kaq të madhe, po ndoshta kemi të bëjmë me ekzekutime të buxhetit, shpenzimet për telefoni mobile janë rrite bukur shumë prej 1216 euro në 6586. Unë e di që e ka bërë një rreth kryetari, por mu doke shumë, kjo rritje është për një vit, po ashtu shpenzimet postare për mu edhe vitin e kaluar kanë qenë pak shqetësuese të mëdha edhe në këtë vit, sigurish do të na jepni një sqarim qyshe krijohen këto shpenzime. Shpenzimet kontraktuese të tjera nga 33138 kanë kalu në 63109 euro, vërtet janë të mëdha, në kemi kërkim me herët për me na sqarim në fund të faqes ose me një fusnotë çka janë. Po ashtu pajisje tjera 13382 euro, të specifikohen qarte çfarë pajisje dhe për çfarë qëllimi janë, ku janë përdorë. Furnizimi me dokumente bllanko 6372 euro, me sa e pashe unë ky kod nuk ka qenë vitin e kaluar, si kod u fute tash, nëse nuk jam i gabim një sqarim, çka nënkuptoj këto dokumenta bllanko dhe për çka janë përdorë. Të mirëmbajtja dhe rregullimi i automjeteve, kemi një kursim, me sa e pashe unë 1000 e disa euro, shpenzimet e informimit publik 30852 euro për komune të Drejtorisë së Kulturës kanë mbi 13000 euro, nëse ka mundësi drejtore një sqarim. Këto vitin e kaluar kanë qenë 3847 euro, tash 30852 euro, është kërkesë e imja që në seancën e ardhshme të na dokumentohet këto shpenzime, se perime janë ekstreme, besoj që edhe për juve janë ekstreme, me kontrata edhe me fatura të dëshkohet, të sillen, d.m.th kontratat për këtë lloj shpenzimi të shoqëruara me fatura, në mënyrë që ta dokumentojmë edhe materialisht emërtimin, natyrën, se për muaj janë të pa pranishme si shpenzim kaq të mëdha, ka krahasime me vitin 2015 në shumë zero. Unë mendoj që është mirë, mirëpo disa janë shqetësuese. Të Drejtorisë së Kulturës, shërbime kontraktuese tjera 43660 euro, për çka janë shpenzuar këto duhet të informohemi. Të planifikimi, p.sh.: kjo po me duket na u ka bartur prej vitit të kaluar, të hyrat nga shkollat e mesme janë planifikuar 3000 janë inkasuar 0 (zero), po ashtu të teknika janë planifikuar 6000 janë inkasuar 0 (zero). Është një inkasim shumë i

vogël, janë planifiku 6000 e 3000, janë inkasui 653 euro. Muj me thanë 10% është realizu plani është shume i ulte pse është planifiku keq. Po ashtu te hyrat nga shtëpia e kulturës janë planifiku diçka, po nuk u inkasu fare nga arkivi. Po ashtu edhe te Drejtoria e Gjeodezisë leje urbanistike, janë planifiku për leje urbanistike 4350 euro, inkasimi është shume i ulët, diku realizimi vetëm 4.51% për gjashtëmujorë, 2.64% për komplet vitin. Qiraja nga hapësirat publike, unë mendoj qe këtu inkasomi duhet te jete 100% për 100%, se nuk ka as një kuptim këtu mos me qenë inkasimi 100% për 100%, e ku nuk është bere inkasimi 100% për 100%, u be diku 90%, unë personalisht nuk jam i kënaqur as me donacionet, e di qe kryetari ka qenë i fokusuar dhe u mundu ne atë drejtim, por donacionet 102 euro janë pak për këtë periudhë, shpresoj qe te rriten deri ne funde te vitit. Po ashtu te hyrat vetanake qyshe janë planifiku, janë shume me ultë, edhe prezantimi analitik i investimeve për periudhën janar-qershor 2016 janë paraqitur këto firmat ose personat juridik qe na kanë kry shërbime te ndryshme, furnizime, investime e ndërtimi i ambulancës e fshatin Skifteraj. Brahimi, unë mendoj qe ky sigurisht ose ka qenë dashur qe këtu me pas subjekti juridik firma apo diçka mos ka qenë dashur te jet SHPK ose NTP, se kështu po me del si emër fizik. Te shpenzimet ne investime kapitale te vitit 2016 janë me te larta për 255746 ne krahasim me vitin 2015, e kjo nënkupton ekzekutimin ose paret qe janë paguar ka qene dashur ndoshta këtu mu shkru për gjashtëmujorin, se del se investimet kapitale i kemi me te mëdhaja 2016, po na e dimë qe nuk na ka ardhur mirë as neve këtu ne asamble ase ekzekutivit as qytetarëve, qe ajo çka është, se na ne vitin 2016 kemi investime kapitale me pake se viti 2015, çka qe unë nuk e kisha dëshira këtë as komunës as qytetarëve as vete neve.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje Kryesues, Nënkryetar, Asamblist, Drejtor te drejtorive përkatëse. Pasqyrat financiare qe pasqyrojnë shpenzimet e buxhetit për periudhën gjashtëmujore, qe i kem para veti, duke u bazuar ne këto pasqyra qe janë te nxerrura nga një buxhet, qe ne e kemi aprovu dhe ne e kemi votu, ato qe janë te faktume dhe shume te sakta për shpenzimet qe kanë, ndodhë sa i parket kësaj periudhe, buxheti i shpenzuar ne përqindje 86.66% ne periudhe gjashtëmujore është i shpenzuar shumë mirë. Nëse nalmi dhe i analizojmë shpenzimet prej Zyrës se Kryetarit, qe kemi një rritje për subvencionet, qe është, mirëpo edhe gjate analizave e shikimit te shpenzime neper te gjitha drejtoritë, me ra ne sy edhe te Drejtoria e Shëndetësisë, qe kemi një rritje te shpenzimeve, qe edhe aty nevojat te qytetarëve e dimë te gjithë dhe janë shume te prekshme dhe hine ne shërbim te drejtpërdrejtë për qytetaret e komunës tone. Ajo qe është inkurajuese, kemi rritje te te hyrave vetanake pak a shume, po megjithatë e kemi një rritje besoj qe me një angazhim, se te hyrat vetanake janë mjete qe direkt do t'i shfrytëzojmë dhe do t'i shfrytëzojmë aty ku ka nevojë, do ta rrisim këtë dhe te gjitha do t'i kthejmë ne shërbim e ne investime për te mirën e qytetarëve te Komunës se Vitisë. Përqindja e shpenzimeve për investime kapitale ne periudhe gjashtëmujore prej 45.44%, nëse krahasohet me te njëjtën periudhë te vitit te kaluar, kemi ngritje, e kjo e ku na bënë te shpresojmë qe atë qe e kam thënë me herët, qe e kemi shfrytëzuar vitin e kalua, qe e kemi zënë vendin e pare ne nivel vendi prej 97%, po hi borxh me thane me rrit drejtor edhe besoj se do ta rrisim, nëse e rrisim këtë paran e qytetarit po e shfrytëzojmë ne mënyrën me te mirë te mundshme, dhe po e kthejmë ne shërbim të tyre.

z.Daut Xhemajli: Përshëndetje për te gjithë juve! Unë e kame ndërmend me fol për diçka, qe mendoj qe është edhe obligim i joni edhe përgjegjësi e jona. Theksin du me vënu te të hyrat vetanake, i vetmi burimi ne komune, i cili ka mundësi edhe ka përgjegjësi komuna jone me kujdes dhe me inkasu tu e analizu ketë. Unë mendoj qe jemi shume keq edhe te planifikimi i këtij buxheti, po edhe te realizimi ndoshta hala me keq. Pse po e them këtë, se tatimi ne prone ne pasqyra nuk e kemi mbi 1 milion e gjysmë ose 2 milion obligime te mbledhura,

d.m.th te bartura borxhe e nga ky obligim nuk e di shumën e saktë, i kemi nja 150 mije euro te grumbulluara, i bjen me pak se 10% qe kemi mbledh, tu e pas parasysh qe tash një vit po behet qe u ardh një vendim i qeverise me i fale borxhet, me kusht qe ata qe kane mas 2008 me i kry obligimet, kjo gjendje eshte hala me keq, sepse njerëzit, d.m.th qe e kane obligime as qe e qajnë kokën për atë pune, d.m.th edhe me ja fale obligimet nuk bahen marak ose nuk kujdesen fare. Unë mendoj, qe ne këtë fushë apsolut nuk jemi angazhu, as si Kuvend, as si ekzekutiv e me mos te foli për sektorin atje, qe as rianketimi as fushata, unë mendoj qe janë kane zero. Në këtë aspekt, unë mendoj qe është përgjegjësi e kësaj udhëheqjeje, e edhe e drejtorisë atje, me i aktivizu këta mekanizma, dhe këtë buxhet me e inkasu, ndërsa kur e thashë te planifikimi i keq, na planifikimin e kemi marr gati kopi pas te vitet e kaluara, pse po e them këtë, gjobat nga inspeksioni janë vetëm 100 euro te inkasuar. Nuk mundet me inkasua inspektori jonë ne rast se shkon atje me i venu gjobe edhe thotë nuk e kame pas qare pa ardh, se me ka qu filani, d.m.th na nuk kemi inspektor hiq, ne këtë aspekt nuk munde me realizu te hyra, nuk mund me tregu autoritetin e pushtetit, nuk mund me eleminu naj dukuri negative qe është. Te hyrat nga qiraja, objekte shëndetësore ose shfrytëzimi i hapësirave publike, parkingjet publike, është katastrofë, ngase pagune vetëm ata qe janë me një formë vullnet te mirë ose qe dojnë me e respektuar pake shtetin ose qe i frikohen naj konkurrence a po diçka. Ne kemi një rregullore për objektet e përkohshme, ndërsa asnjë propozim nuk e kemi deri tash, as ata qe e kane shfrytëzuar qe 17 vite këtë pronë këtu pari, pa leje, pa as një letër nuk paguhen as nuk po tentojnë me rregullu këtë, nuk po tham vetëm për këtë udhëheqjeje, po kjo është e bartur kjo problematikë, nuk mundet d.m.th, këtu është objekti qe nja 3,4,5 a 6 vjet, nuk bahet vlerësimi, nuk mundet mu bë vlerësim se një nëpunës nuk ta qet nënshkrimin, ku ka ashtu, as një përgjegjësi, d.m.th ai se paguan qiranë ose obligimet pse një nëpunës i jonë për arsye se ku me dit se çfarë nuk ta qet nënshkrimi, nuk ka ashtu, ose një objekt qe është i përkohshëm ka leje, ne Pozharan e ne Viti, është jo i përkohshëm, po me beton e me tulla e me blloka edhe ai asnjë cent nuk e paguan sot e 17 ose 18 vjet. Pushteti është për këtë, nuk është për 10% qe e paguan tatimin, kontributet hiq pa i dhanë.

z.Bekim Azizi: Faleminderit Kryesues! Mendoj qe një pjese te mirë e than parafolësit, unë po e bëjë një krahasim ne mese te Dautit dhe Vjollces Kadolli-Halili. Shume keq edhe katastrofë e përmendi, dhe shume mirë, unë po e bëjë një krahasim ne mese te këtyre dyve. Dauti nuk paska marre pjese ne 100 e 16 mije euro ne dreka qe i kane hëngër këta dy se edhe ai kish fol sikur këta. Për gjashtëmujor 100 e 16 mijë euro dreka me te vërtet është mire për Vjollcën, sepse për vitin 2014 për një vite janë kane 100 e 16 mijë euro dreka, tashti janë për gjashtë muaj, krahasoni tashti pa qare ka mu kane mirë. Te investimet kapitale, prej 1 milion e 600 mijë, vetëm çka janë kane te planifikime, nëse 347000 euro janë 45%, është çështje tjetër llogaritne qeto çka i kane shpenzu 100 e 16 mije janë te vitit te kaluar, që sun i kanë bere pagesat me kohe, qe i kane bere sivjet. Ja kisha bëre një pyetje, prej postes a e ka marre najkush prej juve, ajo prej tatimit ne pronë askujt nuk i ka ardh, 4000 e disa euro është pagu për shërbimin e postes për tatimin ne pronë, me na njoftu a i kanë pru dikujna këtë shërbim, nëse nuk i ka pru, atëherë duhet me marre masa. Mirëpo qeto shpenzime qe i paguajna ti kontrollomi a është tu i krye mire. Te zotimet, a bane me naj pru qeto me shpenzime te veçanta te kontratat mbi veprën, me emër secili, edhe ne arsim edhe ne administratë, edhe ne shëndetësi, ne te gjitha vendet ku i keni qu me naj pru me emra, qeky është prej qesaj date deri me qet date. Bursat e studentëve vitin e kaluare keni dhënë ne Korrik, me 5 korrik jav keni qite paret për pushime, tashti vitin ka fillu ne shtator viti shkollor po kryhet a u dhanë burës sivjet prej shtatorit deri tash a u dhëne bursa studentëve, nuk janë dhanë, ky vite ka mete pa bursa studentët. Vitin 2014, 2015 i keni dhënë ne Korrik, vitin 2012, 2013 i keni zhduk, nuk

janë dhënë hiq ato mjete, d.m.th qe tri vjet qeverisje njëherë keni dhënë bursa. Te kanalizimi i Smirës dhe Terpezës, a janë pranuar, se këtu nuk janë qe janë paguar, a janë pranuar edhe ku kane ardh, ma merr mendja masi nuk janë pagu edhe nuk janë pranuar.

Kryesuesei z.Naim Pira: Faleminderit Bekim! Pasi qe e adresove një pyetje për krejt këshilltaret komunal, unë po tham se nga posta i kam marre, megjithatë se ka defekte po e pranojmë, mirëpo unë se kame marr nga posta.

z.Daut Xhemajli: Unë du me sqarua, problemi qe e thashë katastrofë e thashë ne kuptimin e ngushtë, jo për krejt senet e problemet, ti kem parasysh. Unë i shof numrat, i di numrat edhe i krahasoj numrat, me krahasua me atë çka kemi planifiku del bajagi për qindje e mirë, po ne thelb unë mendoj qe është katastrofë për ata, kjo puna qe po e tham keq du mu kuptu drejte jo mu keqinterpretuar, se tani e mendon njeri qe për krejt zhvillimet është katastrofë. Katastrofë është ne raste se unë e kame ne kontratë si komune, tjetërkush e shfrytëzon fitim mas fitimi nuk ka, nëse nuk e shfrytëzon ai erifi atje e prish kontratën, e qesim ne ankond, ja japin dikujt qe e shfrytëzon, a jo unë tashti e kame marr atje objektin ne Pozharan edhe fitim mas fitimi ne emër te komunës, kjo është katastrofë, katastrofë është 17,18 vjet midis qendrës se Vitisë pronën me shfrytëzuar pa asnjë cent mos me pagu, ku dikush perskejt pagun 1000 euro qira, dikush asnjë cent, nuk ka ashtu ne këtë drejtime janë katastrofë.

z.Ali Bajrami: Duket nivel shume i ule ke hangar, po e përkrah, unë e përkrahi pasqyrat qe i kemi para vetes.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Faleminderit edhe njëherë për fjalën Kryesues! U benën shume pyetje, do te ju përgjigjem secilës pyetje. Po disa pyetje kur thuhet katastrofë ose zero, nuk i pranoj, për arsye se zero dhe katastrofa janë degradim totale i secilës shoqni, tu fillu edhe prej kësaj qe jemi na sot, edhe për të mos thënë zero, unë po them ka shenja të përmasimit, jeta vazhdon, institucionet ecin ndonjëherë edhe pa dashjen tonë para. Unë shpesh e them në mënyrë figurative, për gjërat që nuk pajtohen njerëzit, ne nuk duhet të mburremi që i kemi bërë këto vite, për shembull se dikush na i ka dhuruar. Në kuptimin e të hyrave vetanake unë shpesh jam pajtuar dhe kam bërë apel që e dini të gjithë, kudo që kam qenë prezent, që kjo është një sektor ku Komuna e Vitisë duhet të ketë një qasje shumë më të madhe, jo vetëm qeveria komunale, por edhe këshilltarët komunal, dhe gjithë trupat e komunës. Në këtë drejtim ne i kemi marr të gjitha hapat në mënyrë ligjore, që e mundëson inkasimin e të hyrave vetanake, dhe ky është një proces që ka filluar që nga viti 2015 dhe do të përfundoj deri më 2 Shtator të këtij viti, falja e borxheve. Falja totale e të gjithë tatimit në pronë të qytetarëve të komunës sonë, sikur ta kishin paguar deri më 2 Shtator është 900 mijë euro në tatimin në pronë. Sa i përket planifikimit, planifikimi i të hyrave vetanake është një proces që fillon në qeverinë e Kosovës, Ministrinë e Financave, dhe atje na i caktojnë kufijtë në inkasimin e të hyrave vetanake komunale për një vit fiskal. Në vitin 2015 të hyrat vetanake kanë qenë 1 milionë e 800 mijë euro dhe është parë që atë vit ka pas planifikim jo të drejtë në kuptimin e performancës së kaluar dhe praktikës që ka ndodhur deri në vitin 2015, dhe në këtë vit e kemi 935 mijë e 900 euro të hyra të planifikuara për inkasim, kurse për vitin 2017 me qarkoren e parë e kemi një shtim për nja 100 mijë euro, domethënë një milion e 163 mijë e kemi kufirin maksimal të inkasimit të hyrave vetanake. Unë kisha me qenë i pajtimit me të gjithë ata që thonë, jo me i mbledhur Komuna e Vitisë 1 milionë e 163 mijë, por 2 milionë e 163 mijë, por ndikojnë shumë rrethana në këtë kuptim, duke përfshirë edhe borxhet e ndryshme.

Kur është fjala për tatimin në pronë, kryesisht te pjesa dërmuese, afër 60% është i këtyre të hyrave nga tatimi në pronë. Planifikimin intern, unë aty pajtohem që mund të ketë shumë defekte kur e kemi miratuar buxhetin e vitit 2015, dhe ato i kemi shpërndarë nëpër drejtori, ndoshta nuk e kemi bërë shpërndarjen e duhur, por ato drejtori që kemi menduar që nuk

munden me inkasuar gjatë vitit, jemi munduar edhe atë deficit, që me qenë përqindja si total i inkasimit të hyrave, të jetë i njëjtë, por askush nuk na pengon që ne të marrim vendim për rritjen e të hyrave vetanake në ata sektor, që ne mundem me inkasuar, duke filluar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave e të gjitha drejtorive tjera, që janë të parapara për inkasimin e të hyrave vetanake. Megjithatë limitet e të hyrave vetanake i përcakton ministria përmes qarkoreve që na i dërgon neve. Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë, e kam thënë edhe më herët, që ka mundësi të mos shkohet në të gjitha familjet, por shpërndarja më të mirë e ka bërë posta se ne që e kemi bërë si komunë edhe pse kemi shpenzuar diku rreth 5000 euro, megjithatë shpërndarja me fletëkthim do të kishte qenë më e mira, por ajo po kushton shumë, kështu që në këtë drejtim kemi defekt. Një pyetje tjetër ishte kanalizimi i Smirës, nuk e kemi paguar pjesën e fundit dhe gjithnjë kam thënë që ky është që disa vite si projekt i papërfunduar, derisa nuk pranohet teknikisht me të gjitha kriterit që i precizon projekti i kanalizimit në drejtorinë tonë nuk do ta paguajmë këtë projekt, prandaj edhe në këto pasqyra nuk ka të përfshira në këto të hyra financiare një pagesë të tillë. Kodi 14310 janë drekat zyrtare, si fond është i miratuar nga Kuvendi që ky kod ti ketë këto shpenzime për dreka zyrtare, për ta hequr dilemën të krahasimi i shpenzimeve, por këtu nuk mund të bëhet krahasim, sepse krahasimi është vetëm udhërrëfyes për projektet në vijim, por jo ndonjë tezë profesionale për të dhënë mjete, sepse planifikimi i buxhetit të çdo viti ndryshon. Ky kod kap shumën e drekave zyrtare 16242 euro, nga kjo shumë për dreka zyrtare për ditën e mësuesit është vlera 2317 euro, për manifestimin “Flakadani i Karadakut” 4380 euro dhe pjesa tjetër e drekave është pjesë e të gjitha drejtorive në nivel komune dhe kjo shumë kap vlerën 9500 euro. Kodi 14230 është shpenzimet për informimet publik, vlera 30852 euro, në këtë shumë bëjnë pjesë shërbimet për informim publik, transmetimi televiziv i seancave, aktivitetet tjera 3570 euro, furnizimi me gazeta ditore 252 euro dhe punimi i dokumentarit në bashkëpunim me “Cross Border” 27030 euro. Kodi 13503 furnizimi me kompjuter për të gjithë administratën komunale, pra fjala është për kompjuter. Kodi 13501 është furnizimet me inventar nëpër të gjitha shkollat e Komunës së Vitisë, vlera prej 34180 euro dhe këtu përfshihen furnizim me inventar të shkollave “Dëshmorët e Vitisë”, “Kuvendi i Lezhës”, “Halil Alidema”, “Njazi Rexhepi”, Zyra e Kryetarit dhe ambulanca në Pozheran. Kodi 14010 është mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve në shëndetësi, në arsim dhe të administratë. Kodi 13320 shpenzimet e telefonisë mobile, kryetari 262 euro dhe pjesa tjetër shpenzimet e telefonisë mobile për të gjitha shpenzimet e telefonisë që i paguajmë në nivel të komunës. 13330 shpenzimet postare kjo është fjala për shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë. 13460 është kodi për shërbime kontraktuese përfshin pagat e punëtorëve të Cross Border 5760 euro, subvencionimi i shoqatave dhe klubeve tjera shuma 28 mijë euro, komisioni i auditimit dhe komisionet tjera 580 euro, pagat e punëtorëve për shkuarjen në pension 1260 euro, hartimi i planit komunal për efikasitet të energjisë 3200 euro, organizimi i panairit nga Cross Border 9600 euro dhe kontrata për shërbime të veçanta 14 mijë 700 euro. Përqindja e shpenzimeve kapitale është 45% për këtë 6 mujor krahasim me të njëjtën periudhë të vitit kaluar që ka qenë 33%.

Kryesuesi z. Naim Pira: Faleminderit Drejtor, i japim fjalën drejtorit Skender Ahmeti.

Drejtori z. Skender Ahmeti: Ishte një pyetje që paskan një shumë të gjobës mandatore diku 100 euro, unë po ju them sinqerisht se këto pasqyra financiare nëse i keni analizuar dhe ka pas një rritje në krahasim me 6-mujorin e vitit të kaluar, është si pasojë e presionit të madh që inspeksioni u bënë të gjitha bizneseve që ti marrim lejet ose të pajisen me dokumentacioni përcjellëse. Mendoj që edhe Drejtoria e Urbanizmit, përkundër që i ka liruar taksat ka rritje, Drejtoria e Bujqësisë i ka tejkaluar 100%, Drejtoria e Inspeksionit e ka kaluar 100%, Drejtoria e Gjeodezisë i ka kaluar po ashtu 100%. Të gjitha këto janë bërë që po u bëjmë presion. Ne këtë

vit i kemi shpallur luftë ekonomisë joformale, ai 100 eurosh që është i gjobës mandatore është për shkak se pala nuk e ka paguar brenda afatit të paraparë kohorë, të gjitha ato gjoba që nuk paguhen brenda këtij afati i dërgojmë në gjykatë. Vetëm në sferën e ndërtimit në këtë 6-mujor janë diku mbi 40 lëndë, që janë proceduar si lëndë në gjykatë, minimumi i dënimit është 1000-10000 euro, Në sferën e uzurpimit kemi shumë lëndë, në sferën e tregtisë gjithashtu, e më erdh shumë keq që the se me inspeksion nuk ka veç se me 100 euro, prandaj dobia e inspeksionit është si ata rrobaqepësit që më shumë punon për të tjerët sa që nuk din me i qep rrobat për vetveten.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Fillimisht i falënderoj të gjitha ata që janë interesuar rreth shpenzimit të parasë publike. Unë dola këtu për një arsye, sikur që janë bërë qejfli për të dal para kamerave, po i përcjell anëtarët e KPF-së, të njëjtën pyetje, të njëjtën pyetje, të njëjtën përgjigje po e shtron këtu, po më duket është humbje kohe, prandaj nuk është e mirë ajo. Çështje tjetër, nuk është mirë me shtruar pyetje dhe me dal nga këtu, sepse thuhet udhëtimet jashtë shumë, por të gjitha investimet që vijnë janë rezultat i këtyre vizitave. Dikush i përmendi drekat, po më vjen keq me thënë, por këtë 6-mujor kanë ardhur që nga presidentja, ministrat, koloneli i KFOR-it të gjitha këto shkaktojnë shpenzim, por duke thënë nuk janë dhënë bursat për shkak të drekave nuk është e drejtë, qytetarët i dinë të gjitha këto. Çështjen e inkasimit e kemi ngritur edhe ne, jemi duke bërë përpjekje, por duhet thyer trendin e shumë viteve që nuk është inkasuar asgjë. Qeveri më të përgjegjshme dhe e interesuar për të kursyer paranë publike nuk ka pas a do të ketë, është çështje tjetër, prandaj edhe njëherë ju kisha lutur që të kursehem nga një fjalor që nuk iu përket këshilltarëve dhe të ju krijojmë hapësirë të gjithëve.

z.Samet Idrizi: Nënkryetari mu duk pak emocional, por ka fundi dha një zbutje retorike, Drejtor, unë pyeta furnizim me dokumente blanko, ti nuk më dhe përgjigje sigurisht ke harruar, vetëm ta dimë, sepse si kod nuk ka qenë vitin e kaluar e ka hy si i ri. Unë e dëgjova kryetarin kur tha kemi përmirësim, në rregull, në të gjitha sektorët nuk pajtoj ashtu, ka përmirësim dukshëm, por jo në të gjitha sektorët. Unë po hy te një ekonomi familjare, hiç pa hy te institucionet e komunës apo shtetit më lartë, aq sa kanë para e rrisin edhe mirëqenien e vet edhe Komuna e Vitisë aq sa ka para e rrit mirëqenien e vet, ndaq në shërbime, ndaq në investime kapitale e kudo qoftë, buxheti vitin e kaluar ka qenë 2 milionë 335 mijë euro për investime kapitale, e ato kur bëhen shkojnë direkt në mirëqenie të qeverisë. Këtë vit është 1 milionë 674 mijë në start nëse i krahason këto dy vlera pavarësisht nëse ka shkurtime buxhetore e ku ta di unë çdo komunë, këto që i kemi mundeni me thënë jemi duke i menaxhuar mirë aty nuk të kontestoj, por me dal me thënë para kamerës shumë është mirë nuk është ashtu, fatkeqësisht buxhetin e kemi shumë ma të ulët, por këto që janë. Dhe Nënkryetar, unë personalisht 99% mundohem me ia mbajt drejt edhe gjithçka lexoj këtu dhe çka shoh në letër, atë që nuk e shoh në letër nuk e them, mua personalisht 100 mijë euro mu duken pak subvencione, tash informacioni, është ky ndoshta janë më shumë atje, ndoshta 200 mijë e 300 mijë, por nuk po i shoh këtu janë pasqyruar 10200 euro.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi qe nuk ka te tjerë për diskutime rreth pasqyrave financiare, ju falënderoj për kontributin e dhënë.

Pika e tretë

Propozim vendim i dokumentit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Vitisë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Si pikë e tretë e rendit te ditës e kemi propozim vendim i dokumentit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Vitisë, ftoj drejtorin qe te naj elaboron këtë propozim vendime.

Drejtori z.Nexhmedin Jakupi: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për te gjithë te pranishmit, me vendim te kryetarit është formu grupa punues me datën 21.10.2015, për hartimi e vlerësimit te rrezeve ne komunën tone dhe atë ne përbërje prej 15 anëtareve, barrën kryesore për hartimi e këtij dokumenti e ka ba barte normale zyrtaret e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, respektivisht sektori i emergjencës z.Nase Haziri dhe z.Shaip Korrani, te cilët i përgëzoj për angazhimin dhe për punë shtesë qe e kane tregu gjate hartimit te këtij dokumenti. Ky dokumente është shume i rëndësishëm për komune tone dhe është hartuar ne përputhje me ligjet te cilët janë ne fuqi, si Ligji për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Ligj për Mbrojtje nga Zjarri, Ligji për Mbrojtje te Mjedisit, etj. Me këtë dokument është bërë një vlerësim i mirë i rrezeve ne komune tone dhe se ky dokument pas aprovimit ne Kuvend do te jete dokumenti baze i planeve parandaluese dhe reaguese për shpëtimin e jetës, pasurisë, infrastrukturës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Materiali e keni pranuar me kohë, qe mos te ju marr me shume kohë jam i hapur për pyetjet e juaja dhe vërejtjet eventuale do ti shqyrtojmë me seriozitetin me te madhe dhe do ti inkorporojmë ne këtë dokumente, dhe kërkoj qe ta aprovoni këtë dokument.

Kryesuese z.Naim Pira: E hape debatin rrethe kësaj pike.

znj. Mirlinda Sadiku: Me te vërtet është një vlerësim qe ju ka nevojit Komunës se Vitisë, vete fakti prej te dhënave qe janë shkaktuar prej vitit 2004 deri 2015, 1 milion e 200 mije euro dëme flet shumë. Drejtor, te faqja nr. 6, këtu e ki kanali e gelbushit po nuk e ki ceke edhe kanalin e Terpezes qe dine ka një herë me sjell kogjo sasi te madhe te ujite, e kemi faqe nr. 10 shtrirja e pyjeve ne Komunën e Vitisë, te dhënat te cilat janë prezantuar janë nga viti 2004, mu ma merr mendja qe vitin 2016 gjendja e pyjeve është shumë me ndryshe tu e marr parasysh te gjitha ato zjarre e prehje te kohe pas koheshe, pasi qe është dokument ne gjuhën shqipe, i referohem faqes nr. 12, i kemi dy toponime ne gjuhen serbo kroate, duhet te korrigojen, e kemi te numëri i te punësuarve, i kemi 1340, nuk është informatë e saktë, kjo ka qenë kur ka qenë, edhe Kllkoti sipas te dhënave te cilat janë prezantuar në kornizën afat mesme buxhetore, numëri i te punësuarve është me i vogël 1140; 804 ne arsim, 139 ne shëndetësi dhe ne administratë, nuk e kame informatën e saktë, vetëm 1100 qetu sillet. Nuk e di ku e ki marr këtë informate, megjithatë unë te faqja 25, zhvillimi i industrisë ushqimore do te i kontribuoj vëllimi i rritur i lloj llojshem, prodhimit bujqësorë, sidomos pas ndërtimit të sistemit te ujitjes te Shushtë, nuk e di qe ka sistem te ujitjes te Shushtë. Është mirë te ceket, pasi qe te koka mire, qe ky vlerësim i dëmeve, te rrezeve te bëhet dividimi, d.m.th rivlerësimi çdo viti është mirë te thuhet, p.sh.: te knalizimi ne Zhiti, kanalizimi ne Begunce kanalizimi ne Skifteraj nuk është aktiv, është mirë me ja shtu qe është joaktive, po ashtu nuk janë, kanalizimet te cilët janë shtu ne fshatin Ramnishte, Stubell, Gushic e Radivojce, komenti i imi është alarmante, p.sh.: te ndotja e ambientit, ku është bërë një analize e ujërave, te cilët 40% prej tyre derdhen ne lumin “Mourava” ujrat e zeza është shqetësuese, është degraduse qyshe doni thuani, me te vërtet qeverisja komunale duhet ta ketë thekësin edhe te beje diçka për naj kolektor. Ka pas premtu kryetari një donacion prej Austrisë, po se di çka ndodhi me ata donacion, a do te na vije a jo. Te numri i punëtorëve shëndetësor, nuk e ki 134, por i ki 139, sipas te dhënave te prezantuara ne kornizën afatmesme buxhetore, ne muajin e kaluare, është mirë qe informatat te dhënat qe prezantohen, te jen te sakta, për arsye qe te krijohet një memorie institucionale, qe pasardhësit e tjerë ti kenë te dhënat e sakta. Tek faqja 59, nuk e ka parapa edhe ndërtesën e çerdhes si objekt i rëndësisë se veçantë, mu ma merr mendja qe është shume i rëndësisë se veçante, tek numri i nxënësve nuk e ki 9 mije po e ki 10 mije e 871, nëse nuk gaboj ashtu e ka prezentu drejtori, edhe e fundit prej sulmeve te NATO-s ka pasur edhe zbrazje te uraniumit te

varfër, qe është shqetësuese, sidomos ne Rrafshin e Dukagjinit, po megjithatë kemi zbrazje. edhe ne mes të fshatit Lubish dhe Podgorce, me intereson me dite, a keni bërë ndonjë vlerësim, ju nuk keni kapacitete, po qeverisja qendrore, për me bë matjen e këtyre zbrazjeve, si dhe po ashtu me intereson ta di a ka ndonjë vend ne Viti, në Komunë të Vitisë, ne 38 fshatra, ku ka mundësi te ketë mina, këtu nuk është parapa, si dhe ne këtë hartën qe është prezentu, është komplet ne gjuhen serbo-kroate, brenda mundësive ndryshoje.

z.Sami Demelezi: Përshëndetje për nënkryetarin, kryesuesin, Drejtorë e juve Koleg e te gjithë te pranishmit! Me te vërtet është një material voluminoz, jam mundu me e lexu edhe e kame lexu, po po mundohem te jap kontributin time. Ne KPF kam dhëne vërejtje ne propozim vendim, tash është bërë një korrigjim, por edhe ky korrigjim po na imponon diçka tjetër, ndërsa te materiali te faqja 20, te numri i të papunëve, konsideroj qe kjo gjendje nuk ekziston, duke e pasur parasysh, se ne Komune tone jo te gjithë te papunët janë te paraqitur ne Zyrën për Punësim. Te faqja 46, ne disa fshatra qe e tha Mirlinda, gjendja e kanalizimeve është shume me e mirë se sa ne dokumenti qe na është afruar, prandaj duhet te korrigjohen. Te faqja 51, ketu mendoj qe mungon një përshkrim për ambulanten e re ne Pozharan, qe do ta pasqyronte këtë dokument, ngase qe kem bere një ambulante qe është model se si bëhet ambulatat. Faqe 63 deri faqe 67, këto zonat e mbrojtura nuk e di se sa janë nën përcjellje e organeve komunale dhe nga organet qendrore këto zona e mbrojtura, dhe ne faqen 120,121 dhe 122, ku paraqiten një gjendje reale, çfarë është pikat e karburanteve ne territorin e Komunës se Vitisë e veçanërisht këtu ne hyrje te Vitisë nga pjesa e Gërmoves, por çfarë mujn me ndërmarr si organe komunale, kur vërtet aty janë pikat karburanteve qe paraqesin një rrezik, qe është përshkruar.

z.Daut Xhemajli: Pasi qe ne komitet kemi biseduar për formën e propozim vendimit, por kane ndryshuar, po unë mendoje qe edhe ata qe i tha Samiu duhet pak me ndryshe, si te titulli edhe te nenet e propozim vendimit duhet e ketë ndryshime.

z.Sejdi Emiri: Kur e kemi fjalën të rreziku i fatkeqësive natyrore, disa nga ato ishin paraparë në këtë dokument, por kem edhe disa te cilat janë të paparashikuara, kemi pas një rast specifik vitin e kaluar, ku një shtallë ju ka djeg një banori, Sherif Bilallit. Unë nuk e di a u kanë komuna në gjendje me ja dhëne 100 euro, me i thane tu ka djeg, njeri paguan tatim në prone, njeri i paguan kontributet ndaj shtetit, kontributet ndaj komunës, nuk e di shtet dhe komuna a kane mujt me ja kthye një përgjigje, bile se paku 100 euro me ja kompensuar, ndoshta krejt nuk mundet. Unë po propozoj qe me pas edhe një fond special të veçanet edhe për këto fatkeqësitë te cilat janë të paparashikuar, të ju përgjigjem qytetarit. Unë muna me dhanë lloj lloj propozimi në letër, mirëpo konkretisht duhet me pas fonde për me mujte me ju përgjigje qytetarëve.

z.Bekim Azizi: Faleminderit kryesues! Ne si grup do ta përkrahim këtë plan, që është i veprimit, mirëpo mendoj qe ndoshta ishte kane e arsyeshme që në këtë plane të përfshihen ndoshta e ku do ta mendojnë edhe drejtoret rreziqet nga fatkeqësi ne komunikacion, pasi që janë fatkeqësi te tjera te shumta, edhe këtë e cila është një nder rreziqet kryesore, që po paraqiten rreziqet ne komunikacion, edhe rreziqet sikur tash që ka ndodhe nga gropat e ujit kemi edhe gropa tjera që i përdorin për ujitje neper fshatra, që miellin me shume mendoj që duhet me i identifikua ato gropa, me i paraqit si rreziqe te mundshme, se nuk është rasti i parë ky qe ka ndodhe, po ka edhe raste te tjera qe kane ndodhe me herët. Mendoj qe e dhe këto dy pika mujm me i plotësuar, këtë plan me bë me të plotë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi qe nuk ka te tjerë për diskutime, e ku u dhanë disa vërejtje e sugjerime, besoj qe këta te cilët janë kompetente dhe përpilues te këtij vlerësimi i marrin parasysh dhe i inkorporojnë ne dokumentin, e konsideroj edhe te propozim vendimi,

sekretaria e Kuvendit, së bashku me Zyrën Ligjore do t'i marrin dhe do ti korrigojnë këto çështje. Unë po e qes ne votim për miratim: Kush është që të miratohet kjo pikë?, ju lutem me ngritje dore; A ka kundër, a ka abstenime? Konstatoj që me votat e te gjithëve të pranishmeve u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Më kërkoi drejtori i Arsimit z.Qahil Silani, i cili e ka një punë urgjente, diku ne ora 13:00. Ai kishte bërë që të debatoj rreth informatës për Arsim, në mënyre që në pikat e tjera të vazhdojmë me lejen e juaj.

Pasi që u dha pëlqimi nga te gjithë te pranishmit atëherë kemi.

Pikë e katërt

Informatë nga Drejtorja e Arsimit

Drejtori z.Qahil Sinani: Përshëndetje për të gjithë! Sivjet testi i semimaturës është mbajtur me 28 Maj 2016, ku në test murrën pjesë 1040 nxënës. Pas verifikimit të testit, që e ka bërë divizioni për standarde dhe vlerësime i MASHT-it, del se arritshmeria e nxënësve te klasave të nënta në Komunën e Vitisë është 73.41%. Kjo ishte për semimaturë, testin e maturës shtetërore për afatin e qershorit u mbajt si vijon: dita e parë me 4 Qershor 2016, dita e dyte me 18 qershor 2016. Në gjimnaz në Viti kane marr pjesë 445 maturant, ndërsa kanë kaluar 400 maturant ose 90%. Ne teknik ne Viti kane marr pjesë 204 maturant, ndërsa testin kanë kaluar 98 maturant ose 48%. Në gjimnazin Pozharan kane marr pjesë 85 maturant, ndërsa 80 maturant kaluan testin ose 97%. Teknika Pozharan kane marr pjesë 14 maturant, testin e kaluan 2 maturant ose 14%. Gjithsej ne Komunën e Vitisë ne afatin e qershorit morën pjesë 745 maturant, nga te cilët testin e kaluan 580 ose 77.85%. Kjo është ne pika te shkurta, për pyetje urdhëroni.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethe kësaj pike a ka dikush ndonjë pyetje pasi që nuk ka për diskutim.

Pike të pestë

Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Vitisë

Kryesuesi z.Naim Pira: Ky është një plan i cili është miratua diku ne 2014, mirëpo është një plan i cili sugjerohet që te miratohet po thuaj që për çdo vit dhe ne pak jemi vonë ne këtë aspekt, sepse në gjashtëmujorin e parë ka qenë dashur që të miratohet, mirëpo ka qenë një udhëzim administrativ, që edhe atje është vonuar, por sidoqoftë e kemi sjell para juve.

Nënkryetari z.Hasan Alia: Ju faleminderit, nuk do te ju marrë kohe për shkak që e keni marre me kohe materialin. Ky plane i veprimit për transparencë në Komunën e Vitisë, është punuar nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, atë te cilën e tha kryesuesi i Kuvendit, vetëm do te ja shtojë, vonesa me tepe reshte bëre për shkak se ju jeni dëshmitar te asaj se e keni aprovuar një strategji, te cilën është përpiluar dhe gjithherë Zyra për Informim e ka pas ne mendjen e tyre, se pas aprovimit te strategjisë, e cila është strategji tri vjeçare, nuk ka nevojë te jete edhe plani i veprimit. Pas konsultimeve është konstatua se asaj strategji duhet për çdo vite te këtë edhe plane te veprimit për transparencë dhe pikërisht për këtë është kjo vonesë, prandaj ne momentin e shtjellimit te çështjes dhe kjarthesimit e kemi sjell këtu para jush. Nuk po ju marr kohë me shumë, për pyetje e sqarime urdhëroni.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hape debat rrethe kësaj pike të rendit të ditës.

z.Sami Demelezi: Unë konsideroj që është një plani i veprimit i përgatitur me mjaftë përgjegjshmëri nga Zyra e Informimit, e që është edhe për tu përshëndetur, edhe pse para përpilimit dhe miratimit te këtij plani, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun ka qenë shume e përgjegjshme dhe te gjitha aktet dhe vendimet e nxjerra, që nuk kufizohet sipas ligjeve ne fuqi, i ka publiku me kohe dhe ne mënyre shume profesionale edhe pse si komune

qëndrojmë mjaft mirë për sa i parkete transparencës, për shkak edhe jemi tu vlerësuar nga monitoruesit tone për transparence. Konsideroj që me miratimin e këtij plani i kontribuojmë edhe me teje transparencës, andaj ne si grupe jemi pro.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që të tjerë nuk ka për diskutim po e qes ne votim për miratim: Kush është që te miratohet kjo pike?, ju lutem me ngritje dore. A ka kundër, a ka abstenime? Konstatohet që me votat e te gjithëve të pranishmeve u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e gjashtë

Informatë rreth procesit të korrjes-shirjeve

Meçe e kemi drejtorin e Bujqësisë, ja kaloje fjalën që ta bënë një elaborim rrethë kësaj informate.

Drejtori z.Veton Ademi: Faleminderit Kryesues, përshëndetje Nënkryetar, Asamblist, Koleg drejtorë! Më lejoni që shkurtimisht të ju informoj rrethë procesit të korrje-shirjeve. Me që materiali e keni marre me kohë, sipas të dhënave të Drejtorisë për Bujqësi në Komunën e Vitisë, kanë qenë të mbledhura 490 hektar me grurë. Drejtoria për Bujqësisë me kohë ka filluar përgatitjet për procesin e korrje-shirjeve. Ne fillimisht kemi mbajtur takim me pronaret e autokombajnave me kohë, që te formohet edhe komisioni komunale nga ana e kryetarit të komunës, të cilët kanë për obligim, që në fund të procesit të raportojnë me shkrim rrethë procesit të korrje-shirjeve. Procesi i korrje-shirjeve në Komunën tonë ka filluar me 4 Korrik dhe ka përfunduar me 22 Korrik. Sipas komisionit komunal, rendimenti këtë vit në Komunën tonë ka qenë 5800 kg, pra ka qenë një rendimet rekord sa i parkete viteve të fundit fale kushteve klimatike, që kane mbretërua në Komunën tonë dhe punës së sjellshme të fermerëve. Vlen të ceket se ka pasur edhe disa probleme gjate procesit të korrje-shirjeve, siç është rasti i djegies të katër parcelave me grurë dhe një auto kombaji, në përgjithësi procesi ka hec mirë dhe ka qenë rendimet i kënaqshëm.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapë debat për këtë pikë të rendit të ditës, pasi që nuk ka të interesuar, ju falënderoj që të gjithëve për kontributin e dhënë. Mirupafshim në seancat e radhës, dhe një herë po kërkojë nga ju meqë që është dita e diasporës me datën 31 dhe 01 të këtij muaji të jeni prezentë në manifestimet të cilët janë të organizuar nga ana e Komunës e te cilët besoj që do ti bëjnë nder të gjithë atyre që po kontribuojnë dhe për neve që jemi këtu.

Mirupafshim!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12 e 20 min.

Procesmbajtës:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal-Viti
z.Naim Pira
